



ANALIZA E PROPOZIM-BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË 2018



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

CEDA
Center for Economic Analyses

Projekt:

“Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë”

Zbatues:

Vestminister Fondacioni për Demokraci (Maqedoni)

Përpiluar nga:

Qendra për Analiza Ekonomike (QAE)

Autorë:

Marjan Nikollov
Gabriella Dimovska
Ivana Vellkovska

Redaktues:

Damir Neziri
Emil Atanasovski

Nëntor, 2017



Ky produkt është përgatitur në suaza të projektit “Mbështetje për reformën parlamentare të Maqedonisë”, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, me përkrahje të Ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë përmbajtje nuk i pasqyrojnë gjithmonë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë Britanike.



WESTMINSTER
FOUNDATION FOR
DEMOCRACY

ANALIZA E PROPOZIM-BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË 2018

Nëntor 2017

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
PROPOZIM-BUXHET I RM-SË PËR VITIN 2018.....	7
BUXHET I KONSOLIDUAR	7
BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2018	11
Klasifikimi ekonomik – Buxheti i RM-së sipas zërave	11
Klasifikimi funksional – Funksione të Buxhetit të RM-së.....	22
Klasifikimi programues – Programe Qeveritare	24
BUXHETI QENDROR	28
Klasifikimi organizativ – shpenzime të Buxhetit Qendror sipas përdoruesve buxhetor	28
TRANSFERIME TË BUXHETIT TË RM-SË NË KOMUNAT	32
BURIME	33

HYRJE

Propozim-buxheti për vitin 2018, që është lëndë e analizës së këtij dokumenti, është miratuar nga ana e Qeverisë në seancën e 37-të, të zhvilluar më 9 nëntor 2017. Së bashku me Propozim-Buxhetin, **Qeveria ka miratuar edhe Strategjinë Fiskale për vitet 2018-2020, me vonesë prej 5 muajve në krahasim me afatin e përcaktuar me ligj, më 31 maj 2017.** Ajo është dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë si material shoqërues i Propozim-Buxhetit për vitin 2018 i synuar për informim të deputetëve. Strategjia fiskale në vazhdimësi miratohet shumë më vonë nga afati i përcaktuar me ligj. Për shembull, Strategjia Fiskale 2017-2019 është miratuar në tetor të vitit 2016.

Pas përcaktimit të **prioriteteve strategjike**, Qeveria përgatit **strategjinë fiskale¹**, si kornizë afatmesme fiskale për periudhë prej tre viteve, që do të përcaktojë drejtimit dhe qëllimet e politikave fiskale dhe i përcakton shumatat për kategoritë kryesore të të ardhurave të vlerësuar dhe mjetet e aprovuar për këtë periudhë.

Meqë Strategjia Fiskale është miratuar me vonesë, nuk mund qartë të përcaktohet se cilat prioritet strategjike janë ndjekur gjatë përgatitjes së Propozim-Buxhetit, duke marrë parasysh që dokumenti është i nevojshëm gjatë përgatitjes së cirkularit buxhetor, që, nga ana tjetër, duhet të përcaktojë kufizimet për çdo përdorues buxhetor.

Dallimet dhe ngjashmëritë në prioritetet strategjike të përfshirë në Strategjinë Fiskale 2017-2019 dhe Strategjinë Fiskale 2018-2020 janë këto në vijim:

Prioritete strategjike Strategjia fiskale 2017-2019	Prioritete strategjike Strategjia fiskale 2018-2020
<ul style="list-style-type: none"> • zmadhim të rritjes ekonomike dhe të punësimit, rritje të standardit të jetës të qytetarëve dhe jetë më të mirë dhe më cilësore; • integrim i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO; • luftë pa kompromis kundër korrupsionit dhe kimit dhe zbatim efikas i së drejtës; • mbajtje të marrëdhënieve të mira ndëretnike mbi parimet e tolerancës së ndërsjellë dhe respektimit dhe trajtimi i barabartë i gjithëve para ligjit; • investim në arsim, inovacion dhe teknologji informatike si elemente kyçe për krijimin e një shoqërie të bazuar në njohuri. 	<ul style="list-style-type: none"> • zhvillimi i ekonomisë, rritje të punësimit produktiv dhe ngritje të standardit të jetës së qytetarëve; • integrim i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe NATO; • luftë të vendosur dhe jo-zgjedhor me krijimin e organizuar dhe korrupsionin; • sundimi i së drejtës dhe ndërtimi i institucioneve të pavarura; • reforma në arsim dhe investim në inovacione dhe teknologji informatike. • reforma në gjyqësor; • zbatimi i plotë i parimeve të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, ndërtimi i shtetit qytetar dhe kohezionit etnik mbi parimet e tolerancës së ndërsjellë dhe respektimit.

¹Strategjia Fiskale e RM-së 2018 – 2020 <http://www.finance.gov.mk/files/u3/Fiskalna%20Strategjia%20na%20RM%202018-2020.pdf>

Në lidhje me treguesit makro-ekonomik, parashikimet e Qeverisë në vitin 2017 dhe 2018 janë këto në vijim:

Tregues makro-ekonomik		
Tregues:	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018
Rritja e vërtetë e PBV	3%	3,2%
Përqindja e inflacionit	1%	1,7%
Deficiti buxhetor	18.607.000.000	18.233.000.000
Deficiti buxhetor në % nga PBV	3%	2,7%
Borxh publik s % nga PBV²	53,1%	52,4%


² Strategjia Fiskale e RM-së 2017 – 2019 dhe Strategjia Fiskale e RM-së 2018 – 2020.

Propozim-buxhet i RM-së për vitin 2018


BUXHET I KONSOLIDUAR

Të ardhurat e plota të Buxhetit të Konsoliduar/Buxhetit të RM për 2018 planifikohet për 193.512 milion denarë, ndërsa, nga ana tjetër, shpenzimet janë planifikuar të arrihen deri më 211.745 milion denarë. Niveli i të ardhurave dhe shpenzimeve paralajmërojnë ulje të deficitit buxhetor prej 3% të planifikuar në vitin 2017 në 2.7% në vitin 2018.

Deficiti buxhetor (në milion denarë)




Deficiti buxhetor 2018-2017 (në%)




Buxhet i Konsoliduar			
Përshkrim	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
GJITHSEJ TË ARDHURA	187.612	193,512	3%
Të ardhura dhe kontribute tatimore	160.746	170.200	6%
Të ardhura tatimore	108.867	114.797	5%
Kontribute	51.879	55.403	7%
Të ardhura jo-tatimore	17.516	17.201	-2%
Të ardhura kapitale	2.613	1.510	-42%
Donacione	6.737	4.601	-32%
GJITHSEJ SHPENZIME	206.219	211.745	3%
Shpenzime rrjedhëse	179.265	187.100	4%
Rroga dhe kompensime	26.771	27.103	1%
Mallra dhe shpenzime	19.610	17.463	-11%
Transferime në NJVL	17.117	17.947	5%
Subvencione dhe transferime	14.832	17.209	16%
Përfitime sociale	92.720	98.694	6%
Pagesa të interesave	8.215	8.684	6%
Shpenzime kapitale	26.954	24.645	-9%
SALDOJA BUXHETORE	-18.607	-18.233	-2%
FINANCIMI	18.607	18.233	-2%
Të hyra/derdhje	37.133	40.897	10%
Burime vendore	17.834	17.700	-1%
Burime të huaja	17.634	34.839	98%
Depozita ("-" mbledhje të llogarisë)	1.665	-11.642	-799%
Shpenzime/Derdhje	18.526	22.664	22%
Pagesë të detyrimit vendor	9.232	12.246	33%
Pagesë të detyrimit të huaj	9.294	10.418	12%

Projektimet për të ardhurat e plota në vitin 2018 janë më të mëdha për 3% në krahasim me vitin 2017 dhe ajo krijohet kryesisht për shkak të rritjeve të të ardhurave tatimore (për 6% më shumë në krahasim me 2017). Nga ana tjetër, sërish, pritet një rënie e madhe e të ardhurave kapitale (për 42%) dhe të donacioneve (rënie për rreth 32%) në krahasim të të ardhurave të planifikuara për vitin 2017.




Shpenzimet e planifikuara, sërish, vlerësohen të jenë më të mëdha për 3% në krahasim me planifikimet e vitit paraprak. Sipas Propozim-Buxhetit të prezantuar, shkurtim të vetëm shpenzimeve rrjedhimore ka në Zërin Mallra dhe Shërbime, edhe atë për 11% dhe në shpenzimet Kapitale për 9%, ndërsa, rritje të madhe shpenzimeve ka në pjesën e Subvencioneve dhe Transferimeve, edhe atë për 16% nga mjetet e planifikuara paraprakisht. Interesante është të theksohet që Zëri Subvencione dhe Transferime në vitin 2017 ka qenë e planifikuar për 92.720 milionë denarë, me Rebalancimin e fundit është rritur në 94.796 milion denarë, ndërsa në vitin 2018 është planifikuar të arrijë deri më 98.694 milion denarë. Rrogat dhe kompensimet janë rritur vetëm për 1% ndërsa shpenzimet tjera rrjedhimore dhe kapitale rriten mesatarisht për rreth 5%.

Struktura e shpenzimeve (në milion denarë)



Ndryshim në strukturën e shpenzimeve në 2018 (në%)



Ajo që mund të vërehet nga të dhënat e prezantuara është që Qeveria insiston gradualisht të zvogëlojë deficitin buxhetor, edhe atë në 2.7% në krahasim me vitin e kaluar, gjegjësisht për 0.3% pikë përqindjeje si përqindje nga PBV. Ndryshimi i deficitit absolut pritet të jetë zvogëlim për 2%, gjegjësisht për 36.840 milion denarë. Marrja e borxhit nga jashtë shtetit pritet që të rritet për 98%, në krahasim me Buxhetin e planifikuar paraprakisht në vitin 2017. Janë projektuar edhe pagesa të mëdha të borxheve, edhe atë për 33% të tregut të brendshëm dhe për 12 % pagesa më të mëdha në krahasim me 2017 për tregun e huaj. Depozitat që në mënyrë negative rriten në vitin 2018 kanë të bëjnë me mjetet që mblihen në llogaritë depozituese në BPRM.

Deficiti buxhetor	PB 2017	PB 2018	Ndryshimi
FINANCIMI	18.607	18.233	-2%
Të hyra/derdhje	37.133	40.897	10%
Burime vendore	17.834	17.700	-1%
Burime të huaja	17.634	34.839	98%
Depozita ("-" mbledhje të llogarisë)	1.665	-11.642	-799%
Shpenzime/Derdhje	18.526	22.664	22%
Pagesë të detyrimit vendor	9.232	12.246	33%
Pagesë të detyrimit të huaj	9.294	10.418	12%

BUXHETI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2018

Buxheti mund të shfaqet në disa mënyra, gjegjësisht sipas klasifikimeve të ndryshme buxhetore³. Klasifikimet përdoren për identifikim të synimeve specifike të mjeteve buxhetore, për kontroll të përdorimit të qëllimit të mjeteve të aprovuar me buxhetin gjatë zbatimit të buxhetit dhe për përgatitjen e analizave të nevojshme, raporte dhe llogari vjetore.

Buxheti i RM-së shfaqet në klasifikimet vijuese buxhetore:

- **klasifikimi ekonomik** – paraqet një strukturë e kodeve për klasifikim të të ardhurave dhe derdhjeve të planifikuara dhe realizuara, mjete të aprovuar me buxhetin, të drejta për shpenzim, obligime të marra dhe shpenzime dhe shpenzime të realizuara. Në fakt, klasifikimi ekonomik i shfaq gjitha paragrafët që e plotësojnë Buxhetin dhe paragrafët për të cilat shpenzohet buxheti;
- **klasifikimi funksional** – paraqet klasifikim të funksioneve të pushtetit qendror dhe komunat në përputhje me klasifikimin e pranuar ndërkombëtar të përcaktuar nga Kombet e Bashkuara;
- **klasifikimi programues** – paraqet strukturë të kodeve për klasifikim të programeve dhe nën-programeve të përcaktuar me buxhetin;
- **klasifikimi organizativ** – paraqet strukturë të kodeve për klasifikim të përdoruesve buxhetor dhe njësisve të tyre strukturore në strukturën organizative të hierarkisë së shtetit.

Klasifikimi ekonomik – Buxheti i RM-së sipas zërave

Me rëndësi të madhe është të bëhet dallim mes Buxhetit të Republikës së Maqedonisë dhe Buxhetit Qendror.

Në fakt, Ligji mbi Buxhetet i jep definicionet vijuese:

Buxheti i Republikës së Maqedonisë është akt me të cilin planifikohen të ardhurat vjetore dhe derdhjet tjera dhe mjete të aprovuar, dhe i përfshin buxhetin qendror dhe buxhetet e fondeve.

Buxheti qendror është plan vjetor i të ardhurave, derdhjeve tjera dhe mjete të aprovuar, ndërsa vlen për përdoruesit buxhetor të pushtetit qendror dhe përfshin buxhetin themelor, buxhetin e donacioneve, buxhetin e borxheve dhe buxhetin e aktiviteteve vetë-financuese.

³ Ligji mbi Buxhetet, Neni 13 – Klasifikime buxhetore.

Buxheti i RM-së sipas zërave (klasifikimi ekonomik)

Përshkrim	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
Gjithsej të ardhura	224.746.501	234.408.721	4%
Të ardhura tatimore	160.746.814	170.201.737	6%
Të ardhura jo-tatimore	13.843.817	12.525.938	-10%
Të ardhura kapitale	2.612.500	1.509.505	-42%
Transferime dhe donacione	8.111.541	-7.443.422	-192%
Borxmarrje vendore	17.824.000	17.700.200	-1%
Marrje borxh jashtë shtetit	21.147.829	39.514.763	87%
Shitje të letrave me vlerë	10.000	0	-100%
Të ardhura nga pagesa e huave	450.000	400.000	-11%
Gjithsej shpenzime	224.746.501	234.408.721	4%
Roga dhe kompensime	26.771.550	27.102.628	1%
Rezerva dhe të ardhura të papërcaktuar	150.000	200.000	33%
Mallra dhe shpenzime	42.926.749	42.365.162	-1%
Transferime rrjedhëse në njësitë e vetëqeverisjes lokale	17.117.035	17.946.720	5%
Pagesa të interesave	8.214.454	8.683.770	6%
Subvencione dhe transferime	14.844.336	17.217.661	16%
Përfitime sociale	69.240.828	73.584.200	6%
Shpenzime kapitale	26.955.195	24.644.070	-9%
Pagesë të pjesës kryesore	18.526.354	22.664.510	22%



Të ardhura të Buxhetit të RM-së (në mijëra denarë)

Përshkrim	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
GJITHSEJ TË ARDHURA	224.746.501	234.408.721	4%
Të ardhura tatimore	160.746.814	170.201.737	6%
Tatim i të ardhurave, nga fitimi dhe nga fitimet kapitale	26.938.300	30.238.000	12%
Kontribute për sigurim social	51.878.851	55.403.000	7%
Tatime vendore të mallrave dhe shërbimeve	75.300.363	77.782.037	3%
Tatim i tregtisë ndërkombëtare dhe transaksioneve (dogana dhe shpenzime)	5.043.000	5.328.000	6%
Taksa të posaçme të njëhershme	0	0	NA
Tatime të shërbimeve specifike	0	0	NA
Taksa të përdorimit ose lejeve për kryerje të vepërtarisë	1.586.300	1.450.700	-9%
Të ardhura jo-tatimore	13.843.817	12.525,938	-10%
Të ardhura sipërmarrëse dhe të ardhurat nga pronat	501.972	264,238	-47%
Gjoha, taksa gjyqësore dhe administrative	2.371.628	2.092,182	-12%
Taksa dhe kompensime	4.189.939	4.023,056	-4%
Shërbime tjera qeveritare	4.347.964	4.241,454	-2%
Të ardhura jo-tatimore tjera	2.432.314	1.905,008	-22%
Të ardhura kapitale	2.612.500	1.509,505	-42%
Shitje të mjeteve kapitale	1.000.000	200,000	-80%
Shitje të tokës dhe investimeve jo-materiale	1.011.495	606.500	-40%
Të ardhura nga dividendë	601.,005	703.005	17%
Transferime dhe donacione	8.111.541	-7.443.422	-192%
Transferime nga nivele të ndryshme të pushtetit	1.824.088	-11.462.448	-728%
Donacione nga jashtë shtetit	6.276.758	4.011.216	-36%
Donacione kapitale	1.160	1.160	0%
Donacione rrjedhimore	9.535	6.650	-30%
Borxhmarrje vendore	17.824.000	17.700.200	-1%
Detyrime afatgjata	17.824.000	17.700.200	-1%
Marrje borxh jashtë shtetit	21.147.829	39.514.763	87%
Agjenci ndërkombëtare zhvillimore	8.608.385	6.147.763	-29%
Qeveri të huaja	239.444	0	-100%
Marrje borxh tjera jashtë shtetit	12.300.000	32.734.000	166%
Shitje të letrave me vlerë	10.000	0	-100%
Shitje të letrave me vlerë	10.000	0	-100%
Të ardhura nga pagesa e huave	450.000	400.000	-11%
Të ardhura nga pagimi i huave të dhënë	450.000	400.000	-11%

Buxheti i RM-së në vitin 2018 vlerësohet që do të jetë më i madh për 4% në krahasim me buxhetin e planifikuar për vitin 2017. Ndryshimi më i madh i anës së të ardhurave pritet të zhvillohet në Zërin Marrje borxh jashtë shtetit, edhe atë rritje prej 87%. Ulja më e madhe në përqindje në krahasim me vitin e kaluar pritet të ketë në Zërin të Ardhura Kapitale edhe atë ulje prej 42%, por, gjithashtu, me rëndësi është të përmenden edhe uljet e planifikuara të të ardhurave nga pagesa e huave (-11%) dhe të ardhurave jo-tatimore (10%).

Pjesëmarrje të të ardhurave në gjithsej të ardhurat - Propozim Buxheti i RM-së


Ndryshim në strukturën e të ardhurave në gjithsej të ardhurat – Buxheti i RM sipas zërave në 2018/2017 (në%)



Siç mund të vërehet në figurën më lartë, të ardhurat tatimore janë dominuese në anën e të ardhurave të buxhetit, edhe atë me 73% në vitin 2018. Pas tyre, pjesëmarrje prej 17% (9% në 2017) marrin të ardhurat nga marrja e borxhit jashtë shtetit, pastaj borxmarrja në vend me 8% në dy vitet.


Struktura e zërave të caktuara të të ardhurave dhe dallimeve të tyre në krahasim të vitit paraparak janë shfaqur në figurat e mëposhtme:

Të ardhura buxhetore
(Buxheti i RM-së, në mijëra denarë)




■ Propozim-buxhet 2018 ■ Propozim-buxhet 2017

Ndryshim në të ardhurat tatimore në 2018/2017 (në%)




Të ardhura jotatimore (Buxheti i RM, në mijëra denarë)




■ Propozim-buxhet 2018 ■ Propozim-buxhet 2017


Ndryshim në të ardhurat jo-tatimore në 2018/2017 (në%)



Të ardhura kapitale (Buxhet i RM, në mijëra denarë)




Ndryshim në të ardhurat kapitale në 2018 (në%)



Qeveria e RM-së në vitin e ardhshëm i sjell në minimum planet për të shitur mjete kapitale ose tokë shtetërore, duke marrë parasysh dallimet e mëdha, gjegjësisht uljet drastike në planifikimet për mbledhjen e të ardhurave nga këto paragrafë (të ardhura nga shitja e mjeteve kapitale është zvogëluar për 80% ndërsa të tokës shtetërore për 40%).


Siç ishte përmendur më herët, në Propozim-Buxhetin për vitin 2018 planifikohet marrje e madhe borxhi jashtë shtetit, gjegjësisht për rritje për 166% të Zërit Marrje borxh nga jashtë shtetit. Marrja e borxhit nga Agjencitë Ndërkombëtare Zhvillimore është zvogëluar për 29% ë krahasim me vitin paraprak.

Të ardhura nga pagesa e huave -Buxhet i RM




■ Propozim-buxhet 2018 ■ Propozim-buxhet 2017

Ndryshim në të ardhurat nga huat – Buxheti i RM në 2018/2017 (në%)




Në anën e daljeve, nga ana tjetër, rritje më e madhe e dukshme e shpenzimeve të planifikuar ka në Zërin Pagesa e pjesës kryesore, edhe atë për 18%, gjegjësisht do të jetë 22.664.510 mijë denarë, që me siguri ka të bëjë me këstin e arritur të marrjes së borxhit jashtë shtetit. Zëri i Subvencioneve dhe Transferimeve ka, gjithashtu, një përqindje të madhe të rritjes në krahasim me vitin paraprak, edhe atë për 14%. Vitin e ardhshëm, Qeveria në mënyrë të dukshme do të mbështet ndërmarrjet publike me subvencione të planifikuar.

Pjesëmarrja e shpenzimeve në gjithsej shpenzimet - Buxhet i RM (në mijëra denarë)



Ndryshim në pjesëmarrjen në shpenzimet nga gjithsej shpenzimet – Buxheti i RM në 2018/2017 (në%)




Siç mund të vërehet nga figura më lartë, përqindja më e madhe e shpenzimeve të plota kanë rënie për Përfitimet sociale, dhe këtu bëjnë pjesë pagesat për kompensim të Fondit për Sigurim Shëndetësor, fondin pensional dhe Agjencisë së Punësimit.

Shpenzime të buxhetit të RM-së (në mijëra denarë)			
Përshkrim	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
GJITHSEJ SHPENZIME	224.596.501	234.408.721	4%
Rroga dhe kompensime	26.771.550	27.102.628	1%
Rroga themelore	19.096.559	19.387.720	2%
Kontribute për sigurim social	7.627.822	7.668.817	1%
Kompensime	47.169	46.091	-2%
Rezerva dhe të ardhura të papërcaktuar	150.000	200.000	33%
Rezerva të përhershme (shpenzime të paparashikuara)	100.000	100.000	0%
Rezerva rrjedimore (shpenzime të llojllojshme)	50.000	100.000	100%
Mallra dhe shpenzime	42.926.749	42.365.162	-1%
Shpenzime për rrugë dhe ditore	866.248	770.692	-11%
Shërbime komunale, ngrohje, komunikim dhe transport	3.900.964	3.693.893	-5%
Materiale dhe inventar i imtë	3.720.596	3.677.532	-1%
Riparime dhe mirëmbajtje	1.957.459	1.773.708	-9%
Shërbime të kontraktuara	30.309.421	30.893.961	2%
Shpenzime tjera rrjedhëse	2.120.885	1.476.448	-30%
Punësime të përkohshme	51.176	78.928	54%
Transferime rrjedhëse në njësitë e vetëqeverisjes lokale	17.117.035	17.946.720	5%
Dotacione nga TVSH	2.130.000	2.207.385	4%
Dotacione me synim	313.000	313.000	0%
Bllok dotacione	14.674.035	15.426.335	5%
Pagesa të interesave	8.214.454	8.683.770	6%
Pagesa të interesit ndaj kreditorëve jo-rezident	5.612.074	5.518.670	-2%
Pagesa të interesit ndaj kreditorëve vendor	2.602.380	3.165.100	22%
Subvencione dhe transferime	14.844.336	17.217.661	16%
Subvencione për ndërmarrje publike	429.550	1.649.000	284%
Subvencione për ndërmarrje private	125.500	150.400	20%
Transferime tek organizatat joqeveritare	378.092	455.935	21%
Transferime të ndryshme	13.698.844	14.808.976	8%
Pagesë në bazë të lejeve të kryera	212.350	153.350	-28%
Përfitime sociale	69.240.828	73.584.200	6%
Kompensime sociale	7.864.202	8.044.700	2%
Pagesë të përfitimeve nga Fondi për SPIM	56.816.000	60.547.000	7%
Pagesa për kompensim nga Agjencia e Punësimit	1.660.626	1.942.500	17%
Pagesa për kompensim nga Fondi për Sigurim Shëndetësor	2.900.000	3.050.000	5%
Shpenzime kapitale	26.955.195	24.644.070	-9%
Blerje të pajisjeve dhe makinave	3.770.508	3.368.491	-11%
Objekte ndërtimore	1.236.407	741.149	-40%
Objekte tjera ndërtimore	15.132.288	12.478.185	-18%
Blerja e mobilieve	246.112	287.715	17%
Mallra strategjike dhe rezerva tjera	976.400	986.400	1%
Investime dhe mjete jo-financiare	1.290.011	1.341.124	4%
Blerja e automjeteve	173.329	135.527	-22%
Dotacione kapitale për NJVL	718.610	956.437	33%
Subvencione kapitale për ndërmarrjet dhe organizatat joqeveritare	3.411.530	4.349.042	27%
Pagesë të pjesës kryesore	18.526.354	22.664.510	22%
Pagesa e pjesës kryesore nga kreditor jo-rezident	9.222.964	10.418.510	13%
Pagesë të pjesës kryesore ndaj institucioneve vendore	9.303.390	12.246.000	32%

Struktura e disa prej zërave më të mëdhenj të anës së shpenzimeve nga Buxheti i RM-së është shprehur në figurat më poshtë.


Zëri i shpenzimeve Rroga dhe Kompensime nuk ka pësuar ndryshime të mëdha. Ndryshimet janë prej 1% deri më 2% në krahasim me planifikimet e vitit të kaluar. Vetëm pritet që të ulen në nën-zërin për kompensime.

Ndryshim i shpenzimeve Rroga dhe Kompensime- Buxheti i RM sipas zërave - 2018 krahasuar me 2017




Zëri Shërbime Kontraktuese është zëri më i madh i kësaj kategorie dhe është planifikuar të rritet për 2%. Zëri Mallra dhe Shërbime është zëri i dytë me madhësi i anës së shpenzimeve të Buxhetit të RM-së. Në Zërin Mallra dhe Shërbime ka tendencë të uljes së zërave më të vogla si shpenzime tjera rrjedhëse, inventar i imtë, shpenzime për rrugë dhe ditore, si dhe inventar i imtë, edhe atë për disa përqindje që lëvizin prej 1% deri më 10% zvogëlim, ndërsa nën-zëri Punësime të Përkohshme është planifikuar të rritet për 54% në krahasim me Propozim-Buxhetin e vitit.


Ndryshim në Mallëra dhe Shërbime - Buxhet i RM sipas zërave -2018 në krahasim me 2017



Në zërin Subvencione dhe Transferime, që në përgjithësi do të rritet për 16% në vitin 2018, pjesa më e madhe bie në zërin Subvencione për Ndërmarrje Publike dhe do të rritet për 284%. Ky paragraf në përgjithësi ka të bëjë me ndarjen e mjeteve për MRTV që mund të vërehet duke shikuar nën-programet zhvillimore. Gjithashtu, është parashikuar edhe rritje të Zërit Transferime tek Organizatat Joqeveritare, edhe atë për 21%. Zëri më i madh në subvencione dhe transferime është Zëri Transferime të Ndryshme, që, nga ana tjetër, do të rritet në krahasim me propozim-buxhetin e vitit të kaluar për 8%.



Në lidhje me shpenzimet kapitale, ndonëse Zëri më i madh është Objekte Tjera Ndërtimore, ky paragraf është parashikuar të zvogëlohet për 18%. Gjithashtu, ndonëse është e vogël në krahasim me paragrafët tjerë, Blerja e Automjeteve do të zvogëlohet për 22%, si dhe Blerja e Pajisjeve dhe Makinave për 11%. Në këtë kategori do të zërave do të rriten vetëm Subvencionet Kapitale për Ndërmarrjet dhe Organizatat Joqeveritare (27%), Dotacionet Kapitale për NJVL (38%), si dhe Blerja e Mobilieve (17%).



Transferimet rrjedhëse në NJVL do të rriten për 5%, edhe atë për Dotacionet nga TVSH, dhe Bllok Dotacionet, ndërsa tek dotacionet për qëllim nuk do të ketë ndryshime.

Projektet kryesore që ka prezantuar Qeveria gjatë prezantimit të propozim-Buxhetit janë në vijim:

Infrastruktura rrugore dhe hekurudhore – 3.5 miliardë denarë

- Përfundim i pjesës rrugore D. Kapija - Smokvica
- Rindërtim i infrastrukturës hekurudhore nga Korridori X
- Intensifikim i ndërtimit të binareve hekurudhor nga Korridori VIII
- Mbarim i ndërtimit të binarëve hekurudhor Manastir – Kremnicë
- Ndërtim i pjesës rrugore Gradsko – Drenovë

Infrastruktura komunale dhe energjetike – 5.9 miliardë denarë

- Sistem kombëtar për gaz
- Ujë dhe kanalizim në shumë vendbanime
- Stacione pastrimi
- Zhvillim i barabartë rajonal

Investime në TIRZ – 431 milion denarë

Arsim dhe sport – 2.4 miliardë denarë

- Çerdhe për fëmijë
- Shkolla fillore dhe të mesme dhe shtëpi studentore
- Universitete dhe konvikte studentore
- Objekte sportive

Shëndet – 1.9 miliard denarë


- Rindërtim i enteve publike shëndetësore
- Rindërtim i qendrave klinike
- Pajisje mjekësore

Mbrojtje – 1 miliard denarë

Gjyqësori – 531 milion denarë

Rendi publik dhe siguria – 917 milion denarë

Pagesa e pjesës kryesore – Buxhet i RM sipas zërave
(në mijëra denarë)



Me Propozim-Buxhetin e vitit 2018, projektimet tregojnë që pagesa e pjesës kryesore do të jetë më e lartë nga viti i kaluar për 22%, edhe atë rritje prej 32% në krahasim me buxhetin e kaluar në Zërin Pagesa e pjesës kryesore ndaj institucioneve vendore, dhe 13% të Zërit Pagesa e pjesës kryesore tek kreditorët jo-rezident.


Klasifikimi funksional – Funksione të Buxhetit të RM-së

Duke ndjekur dy Propozim-Buxhetet të viteve 2017 dhe 2018, mund të vërehet që ministrinë e ndryshme (duke marrë parasysh që kemi pasur ndryshim të pushtetit në maj të vitit 2017) në mënyrë të ndryshme shprehin Buxhetin sipas funksioneve që kryen Qeveria. Në fakt, në vitin 2017, Ministria e Financave i shfaq shpenzimet buxhetore sipas funksioneve të Buxhetit Qendror, ndërsa në vitin 2018, shfaqen shpenzimet Buxhetore sipas funksioneve të Buxhetit të RM-së.


Paragrafët e përgjithshme të funksioneve të Buxhetit Qendror për vitin 2017 dhe Buxhetin e RM-së për 2018 janë shfaqur në tabelën më poshtë:

Shpenzime buxhetore sipas funksioneve të Buxhetit Qendror për 2017/Buxheti i RM-se për 2018			
Përshkrim	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
Shërbime të përgjithshme publike	23.755.487	19.170.917	-19%
Mbrojtje	6.466.753	6.602.206	2%
Rendi publik dhe paqe	14.919.087	14.509.544	-3%
Çështje ekonomike	43.175.549	49.529.544	15%
Mbrojtje të mjedisit jetësor	1.181.824	931.280	-21%
Vendbanime dhe zhvillim të komunitetit	4.139.693	5.415.266	31%
Shëndetësi	5.650.771	32.592.749	477%
Rekreacion, kulturë dhe religjion	5.016.196	5.054.510	1%
Arsim	25.492.754	25.413.663	0%
Mbrojtje sociale	41.489.191	75.189.042	81%
Gjithsej shpenzime sipas funksionit	171.287.305	234.408.721	37%

Struktura e shpenzimeve sipas funksioneve të Buxhetit Qendror të RM




Ndryshim i strukturës së shpenzimeve sipas funksioneve të Buxhetit Qendror të RM



Meqë bëhet fjalë për metodologji të ndryshme në vitin 2017 dhe 2018, gjatë shfaqjes së Buxhetit sipas klasifikimit funksional, vështirë është të bëhet krahasim mes dy Propozim-Buxheteve. Ne fakt, sipas tabelës, por edhe shfaqur në mënyrë ilustruese në figurë me poshtë, mund të vërehet dallim në shpenzimet e planifikuara për shëndetësi, edhe atë me 477%. Dallim i madh në shpenzimet e planifikuara ka edhe në Zërin Mbrojtje Sociale, edhe atë me 81%. Këtu duhet të merret parasysh që në vitin 2018, në klasifikimin funksional janë përfshirë edhe Fondi për Pension dhe Invaliditet, Fondi për Sigurim Shëndetësor si dhe Agjencia e Punësimit. Andaj, tek funksionet që janë drejtpërdrejtë të lidhur me këto institucione ka ndryshime më të mëdha. Zëri Arsimit mbetet në nivelin e njëjtë, dhe këtu afër janë edhe shpenzimet për Rekreacion, Kulturë dhe Religjion si dhe për Mbrojtje. Ulje të dukshme të shpenzimeve në krahasim me buxhetin e vitit paraprak ka në paragrafët Mbrojtja e Mjedisit Jetësor (-21%), Shërbime të Përgjithshme Publike (-19%), si dhe për Rendin Publik dhe Paqe (-3%).

Sipas strukturës së shpenzimeve sipas funksioneve të Buxhetit të RM-së për vitin 2018 në shpenzimet e plota, Zëri më i madh është Mbrojtja Sociale me 32% pjesëmarrje, dhe pas tyre janë edhe Çështjet Ekonomike me 21% dhe Shëndetësi me 14%.



Klasifikimi programues – Programe Qeveritare

Ndonëse sikur në Klasifikimin Funkcional, Ministria e Financave në vitin 2017 dhe 2018 në mënyrë të ndryshme e shpreh Buxhetin sipas Programeve Qeveritare. Në fakt, në vitin 2017, Ministria e Financave ka shfaqur Programet Qeveritare të Buxhetit Qendror, ndërsa në vitin 2018 shfaqen Programet Qeveritare të Buxhetit të RM-së.

Zërat e përgjithshme të funksioneve të Buxhetit Qendror për vitin 2017 dhe Buxhetin e RM-së për 2018 janë shfaqur në tabelën më poshtë:


Programe Qeveritare të Buxhetit Qendror për 2017/Buxheti i RM-së për 2018 (në mijë denarë)

Përshkrim	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
Decentralizimi	17.117.035	17.946.720	5%
Masa për uljen e varfërisë	12.153	1.462.650	11.935%
Avancimi i mbrojtjes dhe sigurisë	151.000	935.000	519%
Përforcimi i sundimit të së drejtës	35.720	22.160	-38%
Zhvillimi ekonomik	3.274.236	4.400.594	34%
Reforma në administratën publike	598.595	590.909	-1%
Integrim në BE	9.458.613	5.324.805	-44%
Teknologji informative dhe komunikacioni	147.934	1.336.540	803%
Zhvillimi rajonal	229.135	328.373	43%
Avancimi i mjedisit jetësor	188.730	166.510	-12%
Investime në arsim	1.291.742	899.794	-30%
Gjithsej	32.504.893	33.414.055	3%

Nga tabela më lartë mund të vërehet që Programi Qeveritar Masa për uljen e varfërisë rritet dukshëm edhe atë pothuaj se për 12 për qind. Megjithatë, siç thamë sqarimin në pjesën e klasifikimit funksional, në mënyrë praktike, nuk është e mundshme të krahasohen dy propozim-buxhetet në klasifikimin programor sepse në vitin 2018 janë përfshirë edhe Fondet dhe Agjencia e Punësimit, të cilët, drejtpërdrejtë, ndikojnë mbi programin Masa për uljen e varfërisë.

Në figurën më poshtë janë dhënë ndryshimet e programeve tjera qeveritare, dhe mund të vërehet prej tyre që mjetet për Teknologji informatike dhe komunikacion do të rriten për rreth 800%, por edhe mjetet për Avancim të mbrojtjes dhe sigurisë do të rriten për 519%. Në programin Teknologji Informatike dhe Komunikacion janë përfshirë shpenzimet për veprimtarinë radiodifuzive. Ulje prej 38% do të ketë në programin qeveritar Përforcimi i sundimit të së drejtës, Investime në arsim me -30% dhe Integrim në BE, me ulje prej 44% në krahasim me vitin e kaluar.

Ndryshim i shpenzimeve për Programe Qeveritare në 2018 krahasuar me 2017




Pjesëmarrje më të madhe kanë shpenzimet për Decentralizim, edhe atë me 54% ndërsa më pas me rëndësi të madhe në shpenzimet e plota të planifikuara për programe qeveritare janë Integrimi në BE me 16% dhe Zhvillimi ekonomik me 13%. Gjithsej mjetet që janë planifikuara për të mbuluar programet qeveritare janë vlerësuar në **33.414.055** mijë denarë.

Pjesëmarrja e shpenzimeve për Programet Qeveritare në gjithsej shpenzimet për Programet Qeveritare -2018




Në bazë të të dhënave që Ministria e Financave siguron në Propozim-Buxhetin në pjesën e **programeve buxhetore** dhe treguesve që janë dhënë si numër i të punësuarve dhe shpenzime operative për të punësuar, i përmbledhim institucionet – programet buxhetore që për vitin 2018 parashikojnë ulje të numrit të të punësuarve. Vlerën relative e uljes së të punësuarve e ilustruam bashkë me vlerën relative të ndryshimit të shpenzimeve operative për të punësuar.

Në vlerë absolute, në vitin 2018 pritet numri i të punësuarve në Ministrinë e Punëve të Brendshme të zvogëlohet për 147 punëtorë, dhe ajo është 1% më pak nga gjithsej të punësuar në MPB nga viti i kaluar, ndërsa, parashikohet shpenzimet operative për të punësuar të zvogëlohen për 3%. Siç mund të vërehet nga figura e dhënë më poshtë, ndonëse Pushteti Gjyqësor do të zvogëlojë numrin e të punësuarve për 2%, shpenzimet operative për të punësuar do të rriten për 509%. Gjithashtu, priten ndryshime të mëdha edhe në Agjencinë për Investime të Huaja me uljen e numrit të punësuarve për 33% dhe ulje të shpenzimeve operative për të punësuar për 74%.




Nga ana tjetër, në shumë absolute parashikohet numër më të madh të punësimeve të ketë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, edhe atë me 240 punësime të reja, që është 4% më shumë se ata në vitin 2017, ndërsa, shpenzimet operative për një të punësuar pritet që të rriten për 30%. Në institucionin Kryetar i RM-së parashikohet që numri i të punësuarve të rritet për 7% më shumë se vitin e kaluar, ndërsa shpenzimet operative do të zvogëlohen për 8%. Situatë e njëjtë është në Agjencinë për Kundërzbulim, ku pritet të ketë 11% më tepër të punësuar nga viti i kaluar, ndërsa shpenzimet për të punësuar të zvogëlohen për 7%.

Rritja e numrit të punësuarve dhe ndryshimii shpenzimeve operative për çdo të punësuar



Në vitin 2017, në Propozim-buxhetin është theksuar që në gjitha institucionet – përdorues buxhetor, numri i të punësuarve do të jetë 53.275 ndërsa në vitin 2018 numri i të punësuarve do të zvogëlohet në 44.507 që paraqet ulje për 16%.

Gjithsej të punësuar në institucione - përdorues buxhetor




BUXHETI QENDROR

Klasifikimi organizativ – shpenzime të Buxhetit Qendror sipas përdoruesve buxhetor


Në vitin 2018, Qeveria do të sigurojë mjete për 93 përdorues buxhetor (duke mos përfshirë fondet dhe Agjencinë e Punësimit). Sipas Propozim-Buxhetit, pjesëmarrje më të madhe në shpenzimet e plota për përdorues buxhetor bie në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministrinë e Financave – funksione të shtetit, edhe atë me 23% të shpenzimeve të plota për përdorues buxhetor.

Pjesëmarrja e përdoruesve buxhetor në gjithsej shpenzimet-Buxheti qendror 2018



Gjatë kësaj, rritje më të madhe të buxhetit nga 10 përdoruesit më të mëdhenj buxhetor ka tek shpenzimet e Qeverisë së RM-së, edhe atë me 31% në krahasim me vitin paraprak, pastaj tek Ministria e Transportit dhe Lidhjeve me 28% dhe Ministria e Shëndetësisë me 17%. Prej 10 përdoruesve të parë buxhetor, vetëm tek Ministria e Financave – funksione të shtetit ka ulje prej 1% dhe tek Ministria e Shëndetësisë me ulje të buxhetit për 3% në krahasim me vitin paraprak.

**Përqindje ndryshimit të shpenzimeve për përdoruesit
buxhetor në 2018 në krahasim me 2017**



Shpenzime dominuese të Buxhetit Qendror sipas përdoruesve buxhetor (në mijëra denarë)

PËRDORUES BUXHETOR	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	1.787.387	2.338.311	31%
MINISTRIA E MBROJTJES	6.240.400	6.500.000	4%
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	10.504.687	10.241.000	-3%
MINISTRIA E FINANCAVE – FUNKSIONE TË SHTETIT	39.230.954	39.033.254	-1%
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE	4.600.749	5.901.729	28%
AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	8.669.966	8.635.600	0%
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE	41.448.870	43.582.337	5%
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS	25.064.174	25.002.838	0%
FINANCIMI I VEPRIMTARIVE NGA FUSHA E KULTURËS	4.098.169	4.318.511	5%
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	5.596.159	6.574.765	17%

Për ilustrim, i kemi ndarë gjitha ministritë e Qeverisë, Kuvendin, Qeverinë dhe një pjesë të agjencive që kanë përqindje të konsiderueshme në shpenzimet e plota si përdorues buxhetor. Nga tabela mund të vërehet që Kuvendi i RM-së merre pjesë me 0.3% në Buxhetin Qendror, dhe është zvogëluar për 4% në krahasim me planifikimin e vitit paraprak.

**Ministri dhe Agjenci – shpenzime të buxhetit qendror sipas përdoruesve buxhetor
(në mijëra denarë)**

PËRDORUES BUXHETOR	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Në shpenzime prej gjithsej shpenzimeve	Ndryshimi (%)
KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	601.887	576.518	0,3%	-4%
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË	1.787.387	2.338.311	1,3%	31%
MINISTRIA E MBROJTJES	6.240.400	6.500.000	3,7%	4%
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME	10.504.687	10.241.000	5,8%	-3%
MINISTRIA E DREJTËSISË	335.076	312.896	0,2%	-7%
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME	1.094.900	1.181.000	0,7%	8%
MINISTRIA E FINANCAVE	1.907.252	2.217.161	1,3%	16%
MINISTRIA E FINANCAVE – FUNKSIONE TË SHTETIT	39.230.954	39.033.254	22,1%	-1%
MINISTRIA E EKONOMISË	589.522	640.575	0,4%	9%
MINISTRIA E MJEDISIT JETËSOR DHE PLANIFIKIM-IT HAPËSINOR	626.130	651.300	0,4%	4%
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE LIDHJEVE	4.600.749	5.901.729	3,3%	28%
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE EKONOMISË SË UJIT	851.900	1.172.580	0,7%	38%
AGJENCIA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL	8.669.966	8.635.600	4,9%	0%
MINISTRIA E PUNËS DHE POLITIKËS SOCIALE	41.448.870	43.582.337	24,6%	5%
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS	25.064.174	25.002.838	14,1%	0%
MINISTRIA E SHOQËRISË INFORMATIKE DHE ADMINISTRATË	311.529	1.486.050	0,8%	377%
MINISTRIA E KULTURËS	467.588	353.645	0,2%	-24%
FINANCIMI I VEPRIMTARIVE NGA FUSHA E KULTURËS	4.098.169	4.318.511	2,4%	5%
MINISTRIA E SHËNDETËSISË	5.596.159	6.574.765	3,7%	17%
MINISTRIA E VETËQEVERISJES LOKALE	454.381	443.594	0,3%	-2%


Në vitin 2018 është parashikuar Buxheti i RM-së të ngarkohet me dy institucione të reja – përdorues buxhetor edhe atë Agjencia për Zbatimin e Gjuhës dhe Inspektorati për Përdorimin e Gjuhëve dhe nga ana tjetër janë shuar dy institucione – përdorues buxhetor, edhe atë Komisioni për Verifikimin e Fakteve dhe Këshilli për Prokurime Publike, që sipas vlerës së buxhetit, janë afër institucioneve të reja të hapura.

Përdoruesit buxhetor që kanë buxhete më të vogla në vitin 2018 janë Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, Inspektorati Shtetëror për Vetëqeverisje Lokale dhe Byroja për Përfaqësim të RM-së para Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe buxhetet e tyre parashikohet të rriten për së paku 10% në krahasim me vitin paraprak.

Shpenzime më të vogla të Buxhetit Qendror sipas përdoruesve buxhetor (në mijëra denarë)

PËRDORUES BUXHETOR	Propozim-buxhet 2017	Propozim-buxhet 2018	Ndryshimi (%)
KOMISIONI PËR VERIFIKIM TË FAKTEVE	18.990	0	-100%
KOMISIONI RREGULLATOR PËR STREHIM	9.670	10.437	8%
KËSHILLI PËR AVANCIM DHE MBIKËQYRJE TË REVIZIONIT	7.721	8.496	10%
KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI	5.052	5.540	10%
AGJENCIA PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË KOMUNITETEVE	9.243	9.450	2%
AGJENCIA PËR ZBATIMIN E GJUHËS	0	8.350	100%
BYROJA PËR PËRFAQËSIM TË RM-SË PARA GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTA TË NJERIUT	4.770	5.195	9%
INSPEKTORATI PËR PËRDORIM TË GJUHËVE	0	7.360	100%
INSPEKTORATI SHETËTOR I DEZIVAVE	7.256	6.270	-14%
KËSHILLI PËR PROKURIME PUBLIKE	74.226	0	-100%
INSPEKTORATI SHETËTOR PËR VETËQEVERISJE LOKALE	5.131	5.210	2%

Shkurtime më të mëdha në shpenzimet për përdoruesit buxhetor, 2018 krahasuar me 2017



Në shprehje përqindjeje dhe krahasuar me vitin paraprak, shkurtime më të mëdha ka në buxhetin e Komisionit Shtetëror Zgjedhor prej 64% që është e kuptueshme sepse nuk parashikohen zgjedhje në vitin 2018. Institucioni tjetër me buxhet më të shkurtuar është Agjencia për Investime të Huaja dhe Promovim të Eksportit të RM, me 61% në krahasim me vitin paraprak.

TRANSFERIME TË BUXHETIT TË RM-SË NË KOMUNAT

Buxheti i komunave është plan vjetor i të ardhurave, derdhjeve tjera dhe mjete të aprovuar, dhe përfshin buxhetin themelor, buxhetin e donacioneve, buxhetin e borxheve dhe buxhetin e aktiviteteve vetë-financuese.


Të ardhurat e buxhetit të vetëqeverisjes lokale sigurohen nga burime personale, dotacione të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe nga buxhetet e fondeve, donacioneve të pranuar në vend dhe jashtë (mallra dhe të holla) dhe në bazë marrjes së borxheve nga Buxheti i Republikës, si dhe nga jashtë me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Shpenzimet, nga ana tjetër, e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale i përbëjnë shpenzimet rrjedhimore (rrogat, të pasurat dhe kompensimet, shpenzime për prokurim të mallrave dhe shërbimeve, transferime rrjedhimore dhe pagesa të interesit); shpenzime kapitale (blerje të mjeteve kapitale dhe transferime kapitale) dhe pagesa e pjesës kryesore për hua të marra.

Nga mjetet që fitohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë në vitin 2018 dotacionet e synuara për arsim fillor mbeten të njëjtë, ndërsa, do të rriten shpenzimet për bllok dotacionet për kompetenca të deleguara nëpër komuna, edhe atë për 5% Rritje më të madhe ka tek bllok dotacionet për mbrojtje sociale edhe atë në pjesën e mbrojtjes së fëmijëve, për 10% më tepër në krahasim me 2017.

Pasqyrë e bllok dotacioneve të synuara si kompetenca të deleguara në komuna për vitin 2017

Viti	Dotacione të synuara për arsimin fillor	Bllok dotacione për arsim		Bllok dotacione nga fusha e kulturës	Bllok dotacione për mbrojtje sociale		Dotacione të synuar për zjarrfikës	GJITHSEJ DOTACIONE TË SYNUARA	GJITHSEJ BLOK DOTACIONE
		Arsimi fillor	Arsimi i mesëm		Mbrojtja e fëmijëve	Shtëpi për pleq			
2017	3,000,000	8,870,000,000	4,150,000,000	234,035,000	1,373,870,000	46,130,000	310,000,000	313,000,000	14,674,035,064
2018	3,000,000	9,290,000,000	4,331,557,000	246,684,000	1,511,964,000	46,130,000	310,000,000	313,000,000	15,426,335,000
Ndryshim në 2018	0	420,000,000	181,557,000	12,649,000	138,094,000	0	0	0	752,299,936

Bllok dotacione të synuara - komuna 2018 krahasuar me 2017



BURIME

- Buxheti qytetar për 2017 dhe 2018 - Ministria e Financave
- Ligji mbi Buxhetet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 64/05, 04/08, 103/08, 4/08, 103/08, 156/09, 95/10 156/09, 95/10, 180/11 dhe 171/12).
- Propozim-Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2017
- Propozim-Buxheti i Republikës së Maqedonisë për vitin 2018

